



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM
PËR TË APLIKUAR PËR MONITORUES

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, vendimit nr. 678, datë 4.7.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarin e bashkisë Rrogozhine”, si dhe vendimit nr. 25, datë 6.7.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, që do të zhvillohen më datë 23 korrik 2023” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të caktojë monitorues për bashkinë si më poshtë vijon:

BASHKIA	VENDET VAKANTE
Bashkia Rrogozhinë	1

KRITERET E APLIKANTËVE:

- 1) Të jetë i padënuar,
- 2) Të ketë përfunduar studimet universitare ose të jetë duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë.
- 3) Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike të paktën 2 (dy) vitet e fundit

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë aplikantët për pozicionin e punës, monitorues:

- a) Kërkesën për t’u emëruar si monitorues që përmban: qarkun për të cilin aplikon, përvojën e aplikantit dhe adresën e banimit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e tel./cel.,
- b) Dëshmi penaliteti,
- c) Kopje të noterizuar të diplomës ose vërtetim që është duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë të noterizuar,
- ç) Kopje të dokumentit të identifikimit,
- d) Vetëdeklarim se nuk është anëtar i ndonjë partie politike për 2 (dy) vitet e fundit,

sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhët udhëzimit nr. 3,
datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

- dh) Raport të aftësisë për punë,
- e) Vetëdeklarim i banimit,
- ë) Fotokopje e certifikatës si monitorues në zgjedhje të mëparshme (nëse disponojnë).

AFATI PËR DORËZIM E DOKUMENTEVE:

11.07.2023